

# OUCH!

## NË KËTË EDICION..

- Përmbledhje
- Si funksionon një Anti-Virus
- Këshilla për Anti-Virus

## Ç'është një Anti-Virus?

### Përmbledhje

Anti-virusi është një program sigurie që e instaloni në kompjuter ose në pajisjen tuaj mobile që t'ju mbrojnë nga infektimi me malware. Termi 'malware' është një shprehje gjithpërfshirëse për çdo lloj softueri të dëmshëm si viruset, worm-et, Trojanët dhe spyware. Në fakt, shprehja 'malware' vjen nga bashkimi i dy fjalëve 'malicious' (shq. i dëmshëm, malinj) dhe software (shq. Program, aplikacion). Nëse kompjuteri juaj është infektuar nga një malware, një sulmues kibernetik mund të kompjtojë çdo shtypje tastjere që ju bëni, të vjedhë dokumentet tuaja ose të përdorë kompjuterin tuaj t'i sulmojë tjerët. Edhe pse disa mendojnë të kundërtën, çdo sistem operativ mund të infektohet, përfshi edhe Mac OS X dhe Linux.

### Botuesi i ftuar

Jake Williams është themelues i Rendition Infosec ([www.renditioninfosec.com](http://www.renditioninfosec.com)) dhe është i certifikuar si instruktor në SANS dhe është autor i një kursi. Ai është aktiv në twitter si [@MalwareJake](https://twitter.com/MalwareJake) dhe shkruan në blogun e tij në [malwarejake.blogspot.com](http://malwarejake.blogspot.com).

Ju mund të bleni një softuer anti-virus si program i veçantë, ose shpesh janë pjesë e një pakete sigurie. Problem qëndron në faktin se anti-virusët më nuk mund të luftojnë me sulmuesit kibernetikë, këta të fundit vazhdimisht janë duke zhvilluar dhe duke lansuar lloje të reja të sulmeve, malware. Është e rëndësishme të pranohet ky fakt që të kuptohet që ndersa anti-virusi do t'ju ndihmojë të mbron kompjuterin tuaj, nuk mund të dallojë dhe të ndalë të gjithë llojet e malware. Që ta kuptoni me mirë se pse ndodh kjo, të shikojmë mënyrën si funksionojnë anti-viruset.

### Si funksionon një Anti-Virus

Në përgjithësi janë dy mënyra se si një anti-virus e dallon një softuer të dëmshëm, malware: dallimi i nënshkrimit (ang. Signature) dhe dallimi i sjelljes. Antivirusi e skanon kompjuterin tuaj për të detektuar nënshkrime dhe karakteristika të njehura të softuerëve të dëmshëm. Këtë e realizon duke e krahasuar me një fjalor apo qendër nënshkrimesh të softuerëve të njohur të dëmshëm, dhe nëse diçka përputhet me këto gjurmë në atë fjalor atëherë anti-virusi provon ta neutralizojë atë. Sikurse sistemi imunologjik i njerëzve, qasja me anë të fjalorëve kërkon përditësime sikurse vaksina, që të mbroheni kundër llojeve të reja të malware. Anti-virusi mund t'ju mbroje vetëm ndaj atyre që njeh që janë të dëmshëm. Problemi është se sulmuesit kibernetikë janë duke zhvilluar malware të reja aq shpejt sa zhvilluesit e anti-virusëve nuk mund ta mbajnë hapin. Si rezultat, pa marrë parasysh sa të përditësuar mund ta keni anti-virusin, ka gjithmonë një nënloj të malware që mund ta anashkalojë softuerin tuaj anti-virus.

## Ç'është një Anti-Virus?

Me njohjen e sjelljeve, një antivirus jo vetëm që provon t'i dallojë malware të njohura, po gjithashtu monitoron sjelljen e softuerëve në kompjuterin tuaj. Kur programi bën sjellje të dyshimta, si p.sh. duke provuar të hyjë në një fajl të mbrojtur, ose të ndryshojë ndonjë program, një antivirus i bazuar në sjellje e vëren këtë gjë dhe ju njofton juve. Kjo qasje ofron mbrojtje nga llojet e reja të malware që mund të mos jenë në fjalorin tuaj. Problemi me këtë qasje është se mund të gjenerojë edhe alarme të rrejshme. Ju, përdoruesi i kompjuterit, mund të mos jeni të sigurt se çfarë të lejoni e çfarë të ndaloni dhe pas një kohe bëheni përtacë për të reaguar ndaj atyre alarmeve. Ju mund të vazhdoni të shtypni "Accept" në çdo alarm, duke e lënë kompjuterin tuaj të hapur ndaj ndonjë sulmi. Gjithashtu, derisa të dallohet sjellja e dyshimtë, malware me siguri është aktivizuar në kompjuterin tuaj dhe mund të mos e dini se çfarë veprime ka kryer ky malware para se softueri juaj antivirus ta ketë dalluar.



*Përderisa një anti-virus është pjesë e rëndësishme e sigurisë suaj, nuk mund të dallojë apo ndalë të gjithë sulmet. While anti-virus is an important part of your security, it cannot detect or stop all attacks. Në fund të fundit, ju jeni mbrojtja më e mirë jo vetë teknologjia.*

Anti-virusi është një pjesë e rëndësishme e mbrojtjes së kompjuterit tuaj apo pajisjes suaj mobile, kurdo që është e mundur ne ju rekomandojmë të instaloni një të tillë dhe ta përdorni në mënyrë aktive. Por duhet ta keni parasysh një gjë, se pa marrë parasysh se si funksionon anti-virusi juaj, kurrë nuk mund t'ju mbrojë nga të gjitha llojet e malware. Në fund, në ditët e sotme, ju dhe jo vetëm teknologjia, janë mbrojtja më e mirë kundër sulmeve të kriminelëve kibernetikë.

## Këshilla për Anti-Virus

1. Gjeni një anti-virus vetëm nga burime të njohura dhe të besueshme. Është një mënyrë e shpeshtë e kriminelëve kibernetikë të shpërndajnë programe mashtruese që duken si antivirus e në fakt janë malware.
2. Sigurohuni që keni versionin e fundit të softuerit anti-virus të instaluar, poashtu që abonimi juaj është i paguar dhe aktiv, dhe që softueri juaj është i konfiguruar të përditësohet automatikisht. Nëse kompjuteri juaj ka qenë i fikur ose i shkëputur nga interneti për një kohë, anti-virusi juaj do të ketë nevojë të përditësohet kur ta lidhni përsëri në Internet. Mos i shtyni për më vonë këto përditësime.
3. Sigurohuni që anti-virusi juaj automatikisht i skanon mediumet lëvizëse si USB, dhe poashtu që mbrojtja në kohë reale (ang. Real time protection) është aktivizuar.
4. Kushtoni vëmendje vërejtjeve dhe alarmeve që dalin në ekran të gjeneruar nga softueri juaj anti-virus. Shumica e alarmeve përfshijnë opsionin e dhënies së më shumë informatave ose rekomandimeve çka mund të bëni më tutje. Nëse alarmet vijnë nga një kompjuter i punës, sigurohuni që e keni kontaktuar qendrën e përkrahjes së TI apo mbikqyrësin tuaj.

## Ç'është një Anti-Virus?

5. Mos e çaktivizoni apo çinstaloni softuerin tuaj anti-virus sepse ju duket sikur e ngadalëson kompjuterin tuaj, ju bllokoi një faqe, ose ju ndalon të instaloni një aplikacion. Nëse e çaktivizoni anti-virusin tuaj, ju do të ekspozoheni ndaj një rreziku të panevojshëm që mund të shkaktojë ndonjë incident sigurie. Nëse problemet vazhdojnë me kompjuterin tuaj personal, provoni të kontaktoni zhvilluesin e anti-virusit, vizitoni faqen e internetit për të marrë më shumë informata ose të zëvendësoni anti-virusin tuaj me një tjetër produkt.
6. Mos instaloni disa lloje të programeve anti-virus njëkohësisht. Nëse e bëni këtë kjo do të shkaktojë konflikt në mes tyre, dhe të ulë nivelin e sigurisë së kompjuterit tuaj.
7. Mësohuni të dallini alarmet që nxjerr në ekran anti-virusi i juaj. Sulmuesit kibernetikë mund të krijojnë faqe të dëmshme që mund të imitojnë alarmet e antiviruseve dhe t'ju ofrojnë juve ta rregulloni kompjuterin tuaj. Nëse klikoni në ndonjë link apo buton në këto faqe të dëmshme ju mund të infektioni kompjuterin tuaj.

## Mëso më shumë

Regjistrohuni në buletin tonë mujor për vetëdijësimin mbi sigurinë OUCH!, qasuni në arkivat e OUCH!, dhe mësoni më shumë mbi zgjidhjet për ngritjen e vetëdijes mbi sigurinë të ofruara nga SANS duke na vizituar në faqen <http://www.securingthehuman.org>.

## Edicioni në shqip

Edicioni në shqip i OUCH! është përkthyer nga gjuha angleze nga Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano. Iliri është magjistër i shkencave në administrimin e rrjetave dhe sistemeve kompjuterike, është ligjërues në universitet për lëndë të ndryshme nga fusha e TI, dhe është përgjegjës për sigurinë e teknologjise informative në bankë. Jorida është përkthuese profesionale e gjuhës angleze në OSBE.

## Burimet

- Krahasimet e produkteve Anti-Virus: <http://www.av-test.org/en/>  
Inxhinjeria sociale: <http://www.securingthehuman.org/ouch/2014#november2014>  
Sulmet me Email Phishing: <http://www.securingthehuman.org/ouch/2013#february2013>  
Jam hakuar? Çka të bëj: <http://www.securingthehuman.org/ouch/2014#may2014>

OUCH! botohet nga SANS Securing The Human dhe shpërndahet nën licencën [Creative Commons BY-NC-ND 4.0](https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/4.0/). Lejohet ta shpërndani këtë buletin ose ta përdorni për programet tuaja vetëdijësuese, për sa kohë nuk e modifikoni përmbajtjen e buletinit. Për përkthimet apo më shumë informata, ju lutemi na kontaktoni në [ouch@securingthehuman.org](mailto:ouch@securingthehuman.org).

Bordi editorial: Bill Wyman, Walt Scrivens, Phil Hoffman, Bob Rudis  
Përkthyer nga: Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano



[securingthehuman.org/blog](http://securingthehuman.org/blog)



[/secrethehuman](https://www.facebook.com/secrethehuman)



[@secrethehuman](https://twitter.com/secrethehuman)



[securingthehuman.org/gpl](https://www.securingthehuman.org/gpl)